



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 100, datë 18.03.2021

PËR
LEHTËSIMIN E NGARKESËS SË GJYQITARËVE TË KOLEGJIT
ZGJEDHOR GJYQËSOR, ZNJ. {...} DHE Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 174/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 89, shkronja b) të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 23 dhe 25 pika 3, shkronja dh) të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenin 26 pika 1 shkronja c) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 149, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarëve {...} dhe {...}, protokolluar me aktin Nr. 884/1 Prot, datë 25.02.2021, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. {...}t dhe z. {...}, për një afat deri në 3 muaj, për shkak të thirrjes së tyre në detyrë për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvendin e Shqipërisë, duke i përjashtuar:
 - a) nga procedurat e ndarjes me short në Gjykatën e Apelit Tiranë, të çështjeve që do të regjistrohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
 - b) nga procedurat e plotësimit të trupave të tjerë gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, veç trupit të tyre.
2. Përjashtimisht, vetëm për arsye objektive që lidhen me pamundësinë ligjore të gjyqtarëve të tjerë, gjyqtarët znj. {...} dhe z. {...} mund të përfshihen në procedurat e shortit dhe në plotësimin të trupave të tjerë gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, gjatë periudhës sipas pikës 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Zëvendëskryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR